

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për krime të rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Vahid Halili, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti e Fillim Skoro, anetar me bashkëpunëtorin profesional, Eroll Gashi si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit D.G. nga fshati ..., komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale vrasja e rende nga neni 179 par.1 nenpar.1.8 të KPRK-se, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ankesës së perbashket të mbrojtësve të akuzuarit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.612/16, të datës 17.03.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 12 qershor 2017 mori këtë :

AKTGJYKIM

REFUZOHEN si të **pabazuara** ankesa e Prokurorisë Themelore dhe ankesa e perbashket të mbrojtësve të akuzuarit D.G., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.612/16 të datës 17.03.2017, **VËRTETOHET**.

Arsyetim

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.612/16 të datës 17.03.2017, i akuzuari D.G. është shpallur fajtor për veprën penale vrasja e rende nga neni 179 par.1 nenpar.1.8 të KPRK-se, për të cilin i është shqiptuar dënimi me burgim në kohezgjatje prej 18(tetëmbëdhjetë) vite, e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 13.06.2016 e tutje.

Të akuzuarit në pajtim me nenin 62 të KPRK-se i është shqiptuar dënimi plotësues-konfiskimi i thikes së kuzhines me mbishkrimin SLG 18/10 ROSTFREI, si mjet me të cilin është kryer vepra penale dhe e njëjta të shkaterrohet pas plotefuqishmerisë së aktgjykimit.

Të demtuarit V.G., H.G., R.G. dhe V.Z., kanë hequr dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

I akuzuari është obliguar që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarise perfundimtare të gjykates, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 100 (njëqind) Euro, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pasi që ky aktgjykim të behet i plotefuqishem.

Kundër këtij aktgjykimi, ne afatin ligjor ka ushtruar ankese :

Prokuroria Themelore ne Prishtine, per shkak te vendimit mbi sanksionin penal, me propozim qe Gjykata e Apelit e Kosoves, aktgjykimin e atakuar te gjykates se shkalles se pare ta ndryshoj sa i perket vendimit mbi sanksionin penal ashtu qe te akuzuarit D.G. t'i shqiptoj denim me te larte me burgim, me te cilin denim do te arrihet qellimi i denimit i parapare me nenin 41 te KPRK-se.

Mbrojtesit e te akuzuarit D.G.-av.S.M. dhe N.SH. nga Prishtina, per shkak te vendimit mbi sanksionin penal, me propozim qe Gjykata e Apelit e Kosoves, aktgjykimin e atakuar te Gjykates se shkalles se pare ta anuloj dhe qeshtjen t'ia kthej gjykates se shkalles se pare ne rigjykim dhe rivendosje.

Gjithashtu mbrojtesit e te akuzuarit kane ushtruar edhe pergjegje kunder ankeses se PTH ne Prishtine me te cilen kane propozuar qe ankesa e PTH ne Prishtine te refuzohet si e pabazuar.

Prokurori i Apelit i Kosoves, duke u shjaruar perkitazi me ankesen e PTH ne Prishtine dhe ankesen e perbashket te mbrojtesve se te akuzuarit, me shkresën e vet PPA/I.nr.238/17 të datës 12.05.2017, ka propozuar që ankesa e PTH ne Prishtine te aprovohet si e bazuar ashtu qe te akuzuarit ti shqiptohet dënim me i larte me burgim ndërsa ankesa e përbashkët e mbrojtesve te akuzuarit te refuzohet si e pabazuar,

Gjykata e Apelit e Kosoves, mbajti seancen e kolegjit ne pajtim me nenin 390 te KPPRK-se, ne te cilen moren pjese Prokurori i Apelit, Xhevdet Bislimi, i akuzuari D.G., mbrojtesit e tij av.S.M. dhe av.N.SH., si dhe te demtuarit V.Z., R.G., V.G. dhe H.G..Palet prezente kane mbetur prane pretendimeve ankimore nga ankesat e ushtruara me shkrim duke propozuar qe te njejtat te aprovohen si te bazuara.l dëmtuari H.G. ne emër te dëmtuarve e ka përkrahur ankesën e PTH ne Prishtine.

Gjykata e Apelit e Kosoves, pasi i shqyrtoi te gjitha shkresat e qeshtjes penale, studioi aktgjykimin e ankimuar ne pajtim me dispoziten e nenit 394 par.1 te KPPRK-se dhe pas vleresimit te pretendimeve te cekura ne ankesa gjeti se:

-Ankesa PTH ne Prishtine dhe ankesa e perbashket e mbrojtesve te akuzuarit nuk jane te bazuara.

Edhe pse aktgjykimi i ankimuar i gjykates se shkalles se pare nuk ankimohet per shkak te shkeljeve esenciale te dispozitave te procedures penale, megjithate Gjykata e Apelit e Kosoves te njejtin sipas detyres zyrtare e shqyrtoi edhe ne kete aspekt konform dispozites se nenit 394 te KPPRK-se dhe konstatoi se i njejti nuk permban shkelje esenciale te dispozitave te procedures penale te cilat kjo gjykate i konstaton sipas detyrës zyrtare e as shkelje te ligjit penal ne dem te akuzuarit e te cilat kishin me kushtezuar anulimin e aktgjykimit te shkalles se pare.

Po ashtu as gjendja e fakteve nuk ka qene objekt vleresimi i kesaj gjykate, ngase as me ankese nuk ka mundur te kontestohet sepse i akuzuari ne shqyrtimin gjyqesor te dates 14.03.2017 ka deklaruar se e pranon fajesine per vepren penale per te cilën eshte akuzuar. Trupi gjykues i gjykatës se shkalles se pare eshte pajtuar me nje pohim te tille ngase i njeiti eshte bere pas konsultimin me mbrojtësit e tij dhe eshte aprovuar nga ana e gjykates pasi qe i njeiti eshte mbeshtetur ne prova te cilat gjenden ne shkresa te lendes, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vleresoi ne drejtim te pretendimeve ankimore te PTH ne Prishtine dhe te mbrojtësve te akuzuarit lidhur me vendimin mbi sanksionin penal.

Sa i perket pretendimeve ankimore lidhur me sanksionin penal Prokuroria Themelore ne Prishtine pretendon se gjykata e shkalles se pare perkunder asaj se me rastin e shqiptimit te denimit i ka vlerësuar te gjitha rrethanat relevante lehtesuese dhe renduese megjithate te akuzuarit per vepren penale te kryer i ka shqiptuar denim te ulet me burgim duke patur parasysh shkallen e larte te dashjes per kryerjen e veprës penale..

Sipas vleresimit te Gjykates se Apelit te Kosoves rrethanat qe cekën ne ankesen e PTH ne Prishtine jane te pergjithesuara dhe nuk jane te atij karakteri qe kishin per te arsyetuar shqiptimin e denimit me te larte ngase te njëjtat gjykata e shkalles se pare i ka patur parasysh me rastin e shqiptimit te denimit.

Ndersa mbrojtësit e te akuzuarit me ankese pretendojne se se gjykata e shkalles se pare me rastin e shqiptimit te denimit te akuzuarit nuk i ka vleresuar ne mase te duhur te gjitha rrethanat lehtesuese, se i akuzuari ne momentin e kryerjes se vepres penale ka qene ne gjendje te rende shpirtore per shkak te tronditjes te forte psiqike te shkaktuar nga pala e demtuar, se ka pranuar fajesine, eshte penduar per vepren penale qe ka kryer, i ka kerkuar falje familjes se te demtuarit, se pas kryerjes se vepres penale eshte dorezuar vullnetarisht dhe ka bashkepunuar me organet e drejtesise, se me pare nuk ka qene i gjykuar, se ka qene i liruar nga shërbimi ushtarak si i paaftë dhe se me pare ka patur aksident komunikacioni. Sipas gjykates se shkalles se dyte keto pretendime ankimore te mbrojtësve te akuzuarit nuk qendrojne ngase gjykata e shkalles se pare me rastin e shqiptimit te denimit i ka patur parasysh te gjitha rrethanat lehtesuese te cilat i cekin ne ankese mbrojtësit e te akuzuarit si pranimi i fajesise, se i akuzuari nuk ka qene i gjykuar me pare, se eshte penduar per vepren penale te kryer dhe se ne menyre gjithëperfshirese jane konstatuar te njëjtat dhe jane vleresuar ashtu siq parashihet ne dispoziten e nenit 73 te KPRK-se.

Prandaj, duke patur parasysh rrethanat e cekura me larte, rrethanat e rastit konkret, menyren e kryerjes se vepres penale, kjo gjykate konsideron se denimi me burgim i shqiptuar ne kohezgjatje prej 18(tetembedhete) vite ndaj te akuzuarit eshte ne harmoni me intensitetin e rrezikshmerise shoqerore te vepres penale te kryer dhe me shkallen e pergjegjesise penale te akuzuarit dhe se ky denim i shqiptuar ndaj te akuzuarit eshte ne funksion te parandalimit te kryeresit nga kryerja e veprave penale ne te ardhmen, te bej rehabilitimin e tij si dhe te ndikoj edhe ne personat e tjere qe te mos kryejne vepra penale, duke konsideruar se me denimin e shqiptuar me burg si ne dispozitiv te aktgjykimit te ankimuar do te arrihet qellimi i denimit i parapare me dispoziten e nenit 41 te KPRK-se, andaj e PTH ne Prishtine dhe ankesa e perbashket e mbrojtësve te akuzuarit u refuzua si e pabazuar.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.241/17, Më 12.06.2017

Procesmbajtës
Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetari i kolegjit,
Vahid Halili

Fillim Skoro
